



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 148 Prot.

Tiranë, më datë 13.02.2023

VENDIM
Nr. 56, datë 13.02.2023

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 *"Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë"*, neni 38, pika 2, VKM-së Nr. 208, datë 10.04.2019 *"Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale"*, Urdhrit Nr. 223, datë 03.07.2020 *"Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Sajt"*, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 13.02.2023:

VENDOSI:

1. Miratimin e projektit *"Hartimi i projektit teknik të zbatimit për ndërhyrje emergjente në objektin Monument Kulture Ura e Matit"*, Monument Kulture i Kategorisë së I-rë, hartuar nga UPT në kuadër të Urdhrit të Kryeministrit për *"Koordinimin e procesit për rehabilitimin e Urës së Matit (Zogut) dhe ngritjen e Grupit Ndërishtitucional të Punës në kuadër të këtij procesi"*, me aplikues dhe zhvillues Ministria e Kulturës/ IKTK;
2. Gjatë procesit të zbatimit, siç parashikon dhe legjislacioni për trashëgiminë kulturore, punimet të mbikëqyren sipas Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018, *"Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë"*, neni 72, pika 1 dhe 2;
3. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
4. Ngarkohet Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore për regjistrimin e këtij Vendimi;
5. Ndaj Vendimit mund të ushtrohet ankimi në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR
Eugen KALLFANI


Eugen
Kallfani

Digitally signed by
Eugen Kallfani
Date: 2023.02.14
15:15:53 +02'00'

*Njohësuar me
originalin
Suada
Juriš*

